



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT

PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE TË RAPORTEVE TË AUDITIMIT

Raportet e publikuara gjatë periudhës 01 janar – 30 qershor 2026

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore për vitin 2025

DOKUMENT INFORMUES

Prishtinë 2026

PËRMBAJTJA

HYRJE	3
1. NIVELI QËNDROR	4
2. INSTITUCIONET/AGJENCIONET E PAVARURA	11
3. NIVELI LOKAL	17
4. NDËRMARRJET PUBLIKE	29
5. AUDITIME TË VEÇANTA	46
Shtojca 1 - Përkufizimi i opinionëve dhe konkluzioneve të auditimit	47

HYRJE

Kjo përmbledhje paraqet rezultatet e auditimit të pasqyrave financiare vjetore të entiteteve të audituara për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025. Auditimet janë kryer në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI), me qëllim shprehjen e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe konkluzionit për pajtueshmërinë me kornizën ligjore dhe rregullative në fuqi.

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur rezultatet e raporteve të auditimit për vitin 2025, përfshirë opinionin e auditimit, bazën për opinion, konkluzionin mbi pajtueshmërinë dhe rekomandimet e dhëna për secilin entitet të audituar.

Për informata plotësuese, referojuni Shtojcës 1 – Përkufizimi i llojeve të opinionëve dhe konkluzioneve të auditimit.

Të dhënat e paraqitura në këtë tabelë janë përmbledhur nga raportet e auditimit të publikuara në faqen zyrtare të Zyrës Kombëtare të Auditimit.
<https://zka-rks.org/Reports>

Raportet e publikuara 01.01.2026-30.06.2026

	INSTITUCIONI	OPINIONI	BAZA PËR OPINION (I kualifikuar/ I kundërt)	KONKLUZIONI	REKOMANDIME	
					LLOJI	TOTAL
1. NIVELI QËNDROR						
1	Kuvendi i Republikës së Kosovës	I pamodifikuar		I pamodifikuar	(1) i ri	1
2	Zyra e Presidentit	I pamodifikuar		I pamodifikuar	(2) të reja (1) pjesërisht i përsëritur	3
3	Zyra e Kryeministrit	I kualifikuar	Pasuritë kapitale në vlerë 465,768€, të blera gjatë vitit 2025 nuk ishin regjistruar në regjistrat përkatës (ishin nënvlerësuar), ndërsa pasuritë jo kapitale (nën 1000 EUR) në vlerë prej 6,752€, ishin regjistruar edhe në SIMFK (mbivlerësuar). Shpenzimet në vlerë 21,852€, ishin regjistruar në kategori ekonomike jo adekuate.	I pamodifikuar	(4) të përsëritura	4

4	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	I pamodifikuar		I kualifikuar	(12) të reja (1) pjesërisht i zbatuar (1) i përsëritur	14
5	Ministria e Drejtësisë	I pamodifikuar		I kualifikuar	(3) të reja (3) të përsëritura	6
6	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	I pamodifikuar		I kualifikuar	(4) të reja (7) të përsëritura (1) pjesërisht i përsëritur	12
7	Ministria e Mbrojtjes	I pamodifikuar		I kualifikuar	(2) të reja (1) i përsëritur (3) pjesërisht të përsëritura	6
8	Ministria e Punëve të Brendshme	I kualifikuar	Shpenzimet e prezantuara në PFV ishin keqklasifikuar në vlerë prej 10,065,651€, pasi që ishin ekzekutuar pagesa nga Investimet kapitale bazuar në vendime gjyqësore kryesisht për pagat e Policisë së Kosovës; Detyrimet kontigjente ishin mbivlerësuar për 2,731,577€ si rezultat i mos përditësimit të të dhënave dhe gabimeve në regjistrim.	I kualifikuar	(5) të reja (4) të përsëritura (3) pjesërisht të përsëritura	12

			Policia e Kosovës kishte paguar shtesat për kushte specifike të punës në vlerë prej 26,580€ edhe për zyrtarët që në këtë periudhë kishin qenë të suspenduar; dhe Punonjësit e komunitetit serb edhe gjatë vitit 2025 ishin paguar në vlerë prej 119,999€ pa vijueshmërinë e punës.			
9	Ministria e Shëndetësisë	I pamodifikuar		I kualifikuar	(6) të reja	6
10	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	I kualifikuar	MASHTI në vitin 2025 ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë 3,287,630€ në kategori ekonomike jo adekuate, si rezultat i planifikimit jo të mirë buxhetor dhe pagesave të kryera nga thesari me vendime gjyqësore. Vlera e prezantuar në PFV për pasuritë kapitale ishte e nënvlerësuar për 1,140,570€, për shkak të mosregjistrimit të tyre në regjistrat përkatës të pasurisë. Po ashtu, kishte mbivlerësuar pasuritë për vlerën 11,407€, pasi të njëjtat ishin regjistruar në SIMFK dhe në e-Pasuri. Detyrimet kontingjente në PFV nuk janë paraqitur në mënyrë të saktë, duke rezultuar në nënvlerësim prej 2,360,167€ dhe mbivlerësim prej 2,349€. Kjo ka ndodhur si pasojë e klasifikimit të gabuar të dy lëndëve, të cilat janë trajtuar si obligime të papaguara në vend se të paraqiteshin si detyrime kontingjente. Si rrjedhojë, detyrimet e papaguara janë mbivlerësuar për 2,127,636€, ndërsa detyrimet kontingjente janë nënvlerësuar për të njëjtën vlerë.	I kualifikuar	(1) i ri (8) të përsëritura	9

11	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	I kualifikuar	Vlera e pasurive kapitale të ministrisë ishte e mbivlerësuar për 833,567€ si rezultat i mos-shlyerjes së pagesave të regjistruara në kategorinë investim në vijim, pas përfundimit të projekteve të bashkëfinancuara për komuna. Vlera e pasurive jokapitale e prezantuar në PFV në vlerë 108,195€, ishte mbivlerësuar si rezultat i mos aplikimit të zhvlerësimit për pasuritë nën 1,000€, për më tepër në regjistrin e pasurive nuk figuron as zhvlerësimi i akumuluar.	I pamodifikuar	(2) të përsëritura	2
12	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	I kualifikuar	Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) nuk paraqesin në mënyrë të saktë vlerën e pasurive, pasi që pasuritë kapitale janë mbivlerësuar për 3,130,548€ si rezultat i mbajtjes në regjistra të projekteve të përfunduara dhe pas pranimit teknik dhe përfshirjes së pagesave të regjistruara gabimisht si pasuri e Ministrisë, ndërsa pasuritë jo kapitale janë nënvlerësuar për 1,193,168€ për shkak të mos përfshirjes së të gjitha raporteve në sistemin e MRS-së në regjistrin e pasurive; Mbivlerësimi i regjistrit të obligimeve për 1,019,223€, për shkak të përfshirjes së faturave që nuk i përkasin vitit raportues, apo pa dëshmi që mbështesin obligimin; Detyrimet kontingjente janë nënvlerësuar për 718,181€, për shkak të mos paraqitjes së disa detyrimeve kontingjente, për të cilat janë siguruar dëshmi të mjaftueshme që vërtetojnë se janë padi aktive.	I kualifikuar	(13) të reja (10) të përsëritura (1) pjesërisht i përsëritur	24
13	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	I kualifikuar	Ministria nuk ka prezantuar në mënyrë të saktë llogaritë e arkëtueshme nga lejet ujore në PFV, duke i nënvlerësuar ato për 28,861€. Ministria nuk ka paraqitur një detyrim në vlerë prej 270,000€ në PFV si detyrim i papaguar, duke rezultuar në raportim jo të plotë të detyrimeve. MMPHI ka realizuar pagesa në vlerë prej 469,885€ për 61 punonjës, për të cilët nuk ka evidenca për vijueshmërinë në punë.	I kualifikuar	(13) të reja (10) të përsëritura (3) pjesërisht të zbatuara	26

			Janë identifikuar mangësi në regjistrimin dhe menaxhimin e pasurive, të cilat në total kanë ndikuar në mbivlerësim të pasurive kapitale për 40,172,324€. Po ashtu, në dy raste nuk është siguruar dokumentacioni mbështetës, duke kufizuar procedurat e auditimit për verifikimin e saktësisë së regjistrimeve. Detyrimet kontingjente të prezantuara në PFV ishin të mbivlerësuara për efektin neto prej 7,141€, ndërsa për një padi prej 180,000€ nuk janë siguruar dëshmi përkatëse. Shpenzimet ishin keq klasifikuar në vlerë prej 2,735,190€, duke ndikuar në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive jo adekuate.			
14	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	I kualifikuar	Vlera e llogarive të arkëtueshme në PFV ishte e mbivlerësuar për 1,706,601€. Vlera e detyrimeve kontingjente në PFV ishte e mbivlerësuar për 535,966€ si rezultat i mos përditësimit me kohë të tyre me aktgjykimet e pranuar. Ministria kishte realizuar pagesa në vlerë 120,060€, nga kategoria ekonomike jo adekuate. Vlera e pasurive jo kapitale e prezantuar në PFV ishte e nënvlerësuar për 87,340€, si pasojë e mos regjistrimit të tyre në SIMFK dhe mosfunksionimit të sistemit e-Pasuria në AZHB.	I kualifikuar	(9) të reja (5) të përsëritura (1) pjesërisht i përsëritur	15
15	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	I kualifikuar	Detyrimet kontingjente të ministrisë në PFV ishin të mbivlerësuara për 240,500€. Obligimet e pa-paguara në PFV ishin të nënvlerësuara për 36,443€.	I kualifikuar	(3) të reja (4) të përsëritura (1) pjesërisht i përsëritur	8

16	Ministria e Ekonomisë	I kualifikuar	Ministria nuk kishte prezantuar saktë vlerën e pasurive në PFV, për shkak se vlera e pasurive ishte mbivlerësuar për 6,996,517€ dhe nënvlerësuar për 181,345€. Këto mangësi përfshijnë mosbartjen e pronësisë për projektet e përfunduara të efikasitetit të energjisë të institucionet përfituese, raportimin jo të saktë të pasurive, si dhe mosregjistrimin e disa pasurive në regjistër. Ministria nuk kishte trajtuar dhe regjistruar siç duhet pagesat që ndërlidhen me investimet kapitale, në përputhje me kërkesat për kapitalizimin e tyre, si rezultat vlera e pasurive ishte e nënvlerësuar për 627,643€. Ministria e Ekonomisë gjatë vitit 2025 kishte paguar/shpenzuar nga kategoria ekonomike jo adekuate vlerën prej 223,470€.	I pamodifikuar	(3) të reja (2) të përsëritura	5
17	Ministria për Komunitete dhe Kthim	I kualifikuar	Vlera e pasurive kapitale në Pasqyrat Vjetore Financiare ishte mbivlerësuar për 256,463€, si rezultat i mosmbylljes së investimeve në vijim pas kryerjes së pranimeve teknike, si dhe ishte nënvlerësuar për 5,272€, si rezultat i mosregjistrimit të pasurive kapitale në regjistrin e pasurive.	I pamodifikuar	(1) i përsëritur	1
18	Ministria e Zhvillimit Rajonal	I kualifikuar	Regjistri i pasurive kapitale ishte i mbivlerësuar për 170,321€, pasi Ministria nuk kishte fshirë nga regjistri i pasurisë investimet e përfunduara në projektet e bashkëfinancuara me komunat.	I pamodifikuar	(1) i përsëritur	1

19	Fondet në Mirëbesim	I pamodifikuar		I kualifikuar	(1) i ri (3) të përsëritura	4
20	Fondi për sigurime shëndetësore	I pamodifikuar		I kualifikuar	(2) të reja (2) të përsëritura	4
21	Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës	I kualifikuar	Prezantimi dhe shpalosja e regjistrit të pasurive kapitale në PFV ishte nënvlerësuar për 8,415,650€, ndërsa regjistri i pasurive jokapitale ishte nënvlerësuar për 662,078€ si pasojë e mos regjistrimit të pasurive dhe klasifikimit të gabuar në regjistra. Shpenzimet e prezantuara në PFV ishin keqklasifikuar në vlerë 3,857,681€ duke ndikuar në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive ekonomike adekuate. Buxheti fillestar dhe final i të hyrave në Pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit në Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) ishte nënvlerësuar për 1,048,801€, për shkak të prezantimit jo të drejtë të informatave mbi buxhetin. Si rezultat i mungesës së vlerësimit jo të duhur financiar dhe mos përditësimit të regjistrit, detyrimet kontingjente ishin mbivlerësuar për 233,634€. Stoku farmaceutik i shpalosur në PFV ishte mbivlerësuar për shkak të përfshirjes së artikujve me afat të skaduar në vlerë 58,154€. Në Spitalin e Prizrenit pasuria "Kombi Bus-4 dyer" figuronte në regjistrat e pasurisë, por nuk është arritur të konfirmohet ekzistenca e saj fizike.	I kualifikuar	(5) të reja (7) të përsëritura	12

2. INSTITUCIONET/AGJENCIONET E PAVARURA

22	Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror	I kualifikuar	ASHNA kishte nënvlerësuar pasuritë në vlerë 356,414€, për shkak të mos regjistrimit të tyre në regjistrin e SIMFK-së.	I kualifikuar	(1) i ri (1) i përsëritur	2
23	Agjencia Kosovare e Privatizimit	I pamodifikuar		I kualifikuar	(1) i ri (1) i përsëritur	2
24	Agjencia Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës	I pamodifikuar		I pamodifikuar	(3) të reja	3
25	Agjencia për Informim dhe Privatësi	I pamodifikuar		I pamodifikuar	(1) i ri	1
26	Agjencia për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar	I kualifikuar	Pasuritë kapitale të prezantuar në Pasqyrat Vjetore Financiare ishin të nënvlerësuar për 49,295€.	I pamodifikuar	(1) i ri	1

27	Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit	I pamodifikuar		I pamodifikuar	(1) i ri	1
28	Akademia e Drejtësisë	I pamodifikuar		I pamodifikuar		0
29	Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës	I pamodifikuar		I pamodifikuar		0
30	Autoriteti i Aviacionit Civil	I pamodifikuar		I pamodifikuar		0
31	Autoriteti Kosovar i Konkurrencës	I pamodifikuar		I pamodifikuar		0

32	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	I pamodifikuar		I pamodifikuar		0
33	Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare	I pamodifikuar		I pamodifikuar		0
34	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit	I pamodifikuar		I pamodifikuar		0
35	Gjykata Kushtetuese e Kosovës	I pamodifikuar		I pamodifikuar		0
36	Institucioni i Avokatit të Popullit	I pamodifikuar		I pamodifikuar		0

37	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	I pamodifikuar		I kualifikuar	(4) të reja (1) i përsëritur	5
38	Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore	I pamodifikuar		I pamodifikuar	(1) i ri	1
39	Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil	I pamodifikuar		I pamodifikuar	(1) pjesërisht i përsëritur	1
40	Këshilli Prokurorial i Kosovës	I pamodifikuar		I pamodifikuar	(1) i ri	1
41	Komisioni i Pavarur për Media	I pamodifikuar		I pamodifikuar		0

42	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale	I kualifikuar	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale ka trajtuar në mënyrë të gabuar fondet e inkasuara nga konfiskimi i garancioneve të performancës për rehabilitimin e minierave, duke nënvlerësuar të hyrat për 99,370€. Në dy raste, pasuritë mbi 1,000€ nuk janë regjistruar në vlerën e kostos së blerjes sipas faturës, duke nënvlerësuar regjistrin e pasurive kapitale për 1,698€. Për 19 artikuj me vlerë fillestare 6,893€, zhvlerësimi nuk është aplikuar plotësisht, duke rezultuar në mbivlerësim të vlerës neto të pasurive me 1,195€ në pasqyrat financiare të vitit 2025.	I pamodifikuar	(5) të reja (1) i përsëritur	6
43	Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve	I pamodifikuar		I pamodifikuar	(1) i ri	1
44	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	I pamodifikuar		I pamodifikuar	(1) i përsëritur	1
45	Organi Shqyrtues i Prokurimit	I kualifikuar	Mbivlerësimi i të hyrave për 16,308€. Nënvlerësimi i të hyrave për 4,864€. Nënvlerësimi i pasurive (nën 1,000 €) për 939€ dhe i stoqeve për 2,704€.	I kualifikuar	(5) të reja (3) të përsëritura	8

46	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa	I pamodifikuar		I pamodifikuar		0
47	Universiteti i Prishtinës	I kualifikuar	Pasuria kapitale me vlerë mbi 1,000€ nuk është prezantuar në vlerë të plotë dhe të saktë, për faktin se regjistri i pasurive kapitale nuk ka përfshirë të gjitha pronat që janë në shfrytëzim të UP-së. Këto pasuri përfshinin tri komplekse universitare, dy objekte dhe një parcelë toke. Kjo e kishte nënvlerësuar në vlerë materiale pasurinë e raportuar në PFV-të për vitin 2025, raportin për pasuri kapitale në nenin 19.3.1. Për shkak të natyrës së çështjes, auditori nuk ka arritur të identifikojë vlerën financiare të mosregjistrimit, por gabimi konsiderohet material në aspektin e keqdeklarimit. UP në vitin 2025 ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë 207,053€ në kategori ekonomike jo adekuate, si rezultat i pagesave të kryera nga thesari me vendime gjyqësore. Detyrimet kontingjente në PFV ishin të mbivlerësuara për 58,094€, si pasojë e prezantimit të katër lëndëve të paguara.	I kualifikuar	(6) të përsëritura	6
48	Zyra e Rregullatorit për Energji	I kualifikuar	Nga testimet e realizuara kemi identifikuar nënvlerësim të pasurisë kapitale në shumën prej 74,639€, si rezultat i mosregjistrimit të plotë dhe me kohë të pasurive në SIMFK para përgatitjes së Pasqyrave Vjetore Financiare, dhe mbivlerësim në shumë prej 2,576€ në regjistrin e pasurive nën 1,000€, si rezultat i gabimeve në kalkulimin e zhvlerësimit të pasurive.	I kualifikuar	(7) të reja	7

3. NIVELI LOKAL

49	Komuna e Deçanit	I kualifikuar	Mangësi në regjistrat e pasurive kapitale dhe jokapitale. Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve.	I kualifikuar	(1) i ri (4) të përsëritura (2) pjesërisht të përsëritura	7
50	Komuna e Dragashit	I kualifikuar	Klasifikimi i shpenzimeve në kategori ekonomike jo adekuate në vlerë 183,000€.	I pamodifikuar	(4) të përsëritura	4
51	Komuna e Ferizajit	I kualifikuar	Shpenzimet e prezantuara në PFV në vlerë totale 7,970,067€ nuk janë klasifikuar në kategoritë e duhura ekonomike, por janë raportuar në kategori të gabuara buxhetore, duke ndikuar në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive ekonomike adekuate. Vlera e detyrimeve kontingjente të prezantuara në pasqyrat vjetore financiare ishte nënvlerësuar për 140,738€. Prezantimi jo i saktë i detyrimeve të papaguara në PFV në vlerë prej 127,235€.	I kualifikuar	(8) të reja (10) të përsëritura (1) pjesërisht i përsëritur	19

52	Komuna e Fushë Kosovës	I kualifikuar	Mangësitë e evidentuara në menaxhimin dhe regjistrimin e pasurive kanë rezultuar në pasaktësi materiale në prezantimin e pasurive në Pasqyrat Financiare Vjetore, duke shkaktuar mbivlerësim të pasurive në vlerë totale prej 5,819,755€, si dhe nënvlerësim në vlerë prej 206,707€. Shpenzime në vlerë prej 2,072,136€ ishin realizuar dhe prezantuar në kategorie ekonomike jo adekuate. Mos shpalosja e plotë dhe e saktë e detyrimeve kontingjente në PFV ka rezultuar në nënvlerësim të tyre në vlerë prej 71,513€. Nënvlerësimi i llogarive të arkëtueshme në vlerë prej 27,256€, si rezultat i moszbatimit të plotë të kushteve kontraktuale.	I kualifikuar	(7) të reja (5) të përsëritura (1) pjesërisht i përsëritur	13
53	Komuna e Gjakovës	I kualifikuar	Përmes pagesave direkte nga Thesari bazuar në vendime gjyqësore gjatë vitit 2025, shpenzime në vlerë 2,700,991€ ishin realizuar për paga jubilarë dhe shujta nga kategori ekonomike jo adekuate. Në dy mostrat e testuara kemi identifikuar se komuna kishte bërë nënvlerësim të detyrimeve kontingjente në vlerë prej 355,000€. Ndërsa nga 99 raste të padive për shpronësime, vetëm një rast në vlerë prej 29,577€ ishte prezantuar në shpalosjet e PFV-ve.	I kualifikuar	(10) të reja (5) të përsëritura (1) pjesërisht i përsëritur	16
54	Komuna e Gjilanit	I kualifikuar	Keq klasifikimi i shpenzimeve në kategori ekonomike në vlerë 3,768,965€, si rezultat i ekzekutimit të pagesave bazuar në vendime gjyqësore/përmbartimore. Blerjet e pasurisë në vlerë 1,761,172€ nuk ishin regjistruar në sistemin e SIMFK-së dhe e-pasurisë, duke rezultuar në nënvlerësim të pasurisë në raportin vjetor financiar për këtë shumë.	I kualifikuar	(2) të reja (10) të përsëritura (1) pjesërisht i përsëritur	13

			Detyrimet kontingjente të shpalosura në RFV ishin mbivlerësuar për 152,231€, si pasojë e përfshirjes së pretendimeve të dyfishuara. Obligimet e papaguara të shpalosura në RFV ishin mbivlerësuar për 13,719€, për shkak të mos largimit nga regjistri i faturave tashmë të paguara.			
55	Komuna e Gllogocit	I kualifikuar	Komuna kishte realizuar pagesa dhe regjistruar shpenzime në vlerë 2,341,210€ nga kategori ekonomike jo adekuate, si rezultat i pagesave nga thesari me vendime gjyqësore. Obligimet e papaguara janë nënvlerësuar për 112,664€ si rezultat i mos mbajtjes së evidencave të plota dhe të sakta.	I kualifikuar	(6) të reja (5) të përsëritura (1) pjesërisht i përsëritur	12
56	Komuna e Graçanicës	I kualifikuar	Llogaritë e arkëtueshme ishin të nënvlerësuar në RFV për vlerën prej 1,418,635€. Ishin bërë keqklasifikime të shpenzimeve në kategori ekonomike në vlerë 282,706€. Pasuritë kapitale dhe jokatitale nuk janë prezantuar saktë në RFV, si dhe stoqet ishin të nënvlerësuar për 528,666€, për shkak të mos regjistrimit të tyre.	I kualifikuar	(3) të reja (11) të përsëritura (1) pjesërisht i përsëritur	15
57	Komuna e Hanit të Elezit	I kualifikuar	Pasqyrat Financiare Vjetore nuk prezantojnë një informacion të plotë dhe të saktë, pasi përmbajnë gabime në raportimin e zërave kontabël nëpër pozicione të caktuara. Pasuritë kapitale dhe jokatitale të prezantuara në PFV ishin të nënvlerësuar për 355,607€. Keqklasifikimi i shpenzimeve në kategori ekonomike në vlerë 53,791€.	I kualifikuar	(1) i ri (4) të përsëritura	5

58	Komuna e Istogut	I kualifikuar	Keqklasifikime në kategori të ndryshme ekonomike jo adekuate në vlerë prej 2,231,264€, të cilat janë realizuar përmes ekzekutimi të vendimeve gjyqësore/përmbartimore.	I kualifikuar	(5) të reja (7) të përsëritura	12
59	Komuna e Junikut	I pamodifikuar		I kualifikuar	(2) të reja (2) të përsëritura	4
60	Komuna e Kaçanikut	I kualifikuar	Komuna ka shpenzuar mjete në vlerë prej 285,737€ nga kategori jo adekuate. Pasuritë kapitale në PFV janë nënvlerësuar për 33,059€.	I kualifikuar	(5) të reja (7) të përsëritura (1) pjesërisht i përsëritur	13
61	Komuna e Kamenicës	I kualifikuar	Shpenzimet e prezantuara në PFV ishin të klasifikuara në vlerë në 363,721€, pasi që Thesari ka ekzekutuar pagesa bazuar në vendime gjyqësore nga buxheti i Komunës për paga jubilarë dhe shujta, të cilat janë regjistruar në kategori ekonomike jo adekuate.	I kualifikuar	(1) i ri (4) të përsëritura (1) pjesërisht i përsëritur	6
62	Komuna e Klinës	I kualifikuar	Ishin bërë keqklasifikime të shpenzimeve në kategori të ndryshme ekonomike në vlerë 509,160€. Detyrimet kontingjente të prezantuara në nenin 18 të Raportit Vjetor Financiar ishin të nënvlerësuar për 112,905€.	I kualifikuar	(5) të reja (6) të përsëritura (1) pjesërisht i përsëritur	12

63	Komuna e Kllkotit	I kualifikuar	Mosregjistrimi i pasurive në regjistrat përkatës si dhe mosprezantimi i plotë i tyre në PFV. Dobësi në përgatitjen e PFV-ve. Keqklasifikimi i shpenzimeve.	I kualifikuar	(1) i ri (6) të përsëritura	7
64	Komuna e Leposaviqit	I kualifikuar	Pamundësia për të Siguruar Dëshmi të Pagesave. Mos regjistrimi dhe mos raportimi i pasurive kapitale dhe jokapitale në PFV.	I kualifikuar	(2) të reja (4) të përsëritura (1) pjesërisht i përsëritur	7
65	Komuna e Lipjanit	I kualifikuar	Ishin bërë keqklasifikime të shpenzimeve në kategori të ndryshme ekonomike në vlerë 2,222,992€, përfshirë pagesa për paga jubilarë, shtesa, mallra dhe shërbime që janë raportuar në kategori të gabuara ekonomike.	I kualifikuar	(4) të reja (7) të përsëritura (1) pjesërisht i përsëritur	12
66	Komuna e Malishevës	I kualifikuar	Llogaritë e arkëtueshme të shpalosura në pasqyrat vjetore financiare ishin nënvlerësuar për 944,848€, si rezultat i diferencës ndërmjet regjistratit detaj analitik të llogarive të arkëtueshme me aneksin përkatës të prezantuar në PFV. Po ashtu, në 19 raste tek llogaritë e arkëtueshme të taksës për ushtrimin e veprimtarisë në vlerë 129,229€, si dhe në tre (3) raste të qirave nga shfrytëzimi i pronës komunale në vlerë 35,726€, mungonin dokumentet burimore të llogarive të arkëtueshme; Keq klasifikimi i shpenzimeve në kategori ekonomike në vlerë 664,254€, si rezultat i ekzekutimit të pagesave bazuar në vendime	I kualifikuar	(18) të përsëritura (1) pjesërisht i përsëritur	19

			gjqësore/përmbare, si dhe pagesave të tjera të realizuara nga Komuna; Pasuritë e prezantuara në Raportin Vjetor Financiar ishin të keqdeklaruara, si rezultat i mosregjistrimit të investimeve kapitale dhe investimeve në vijim në vlerë prej 1,717,728€, si dhe mbivlerësimit të pasurive jokapitale për 271,691€; Detyrimet kontingjente të shpalosura në raportin vjetor financiar ishin keqdeklaruara për 266,031€, si rezultat i mos përditësimit të regjistrit pas pagesës së detyrimeve, si dhe mos përfshirjes së plotë të detyrimeve në raste të caktuara.			
67	Komuna e Mamushës	I kualifikuar	Keqklasifikimi i shpenzimeve në vlerë 161,987€.	I pamodifikuar	(1) i ri (2) të përsëritura	3
68	Komuna e Mitrovicës së jugut	I kualifikuar	Regjistri i pasurive dhe vlerat e raportuara në Pasqyrat Financiare Vjetore ishte të nënvlerësuara për 8,338,135€ dhe të mbivlerësuara për 502,232€, si rezultat i mangësive në regjistrimin, klasifikimin dhe evidentimin e pasurive komunale. Vendimet gjyqësore dhe përmbare në vlerë prej 3,150,927€ ishin ekzekutuar nga kategori ekonomike jo adekuate përmes Thesarit, duke rezultuar në keq klasifikim të shpenzimeve në Pasqyrat Financiare Vjetore. Vlera e detyrimeve kontingjente në PVF ishte mbivlerësuar për 228,130€. Vlera e pajisjeve dhe mobilieve e shpalosur në PFV nuk përputhet me vlerën e paraqitur në raportin e sistemit e-Pasuria, me një diferencë prej 877,578€.	I kualifikuar	(10) të reja (7) të përsëritura (1) pjesërisht i përsëritur	18

69	Komuna e Mitrovicës Veriore	I pamodifikuar		I pamodifikuar	(2) të reja (2) të përsëritura (2) pjesërisht të përsëritura	6
70	Komuna e Novobërdës	I kualifikuar	Regjistrimi jo i saktë i pasurive kapitale në regjistrin kontabël dhe prezantimi jo i saktë i pasurive kapitale në PFV, mosregjistrimi dhe aplikimi i pasaktë i pasurisë ka rezultuar me nënvlerësim të pasurive në vlerë 14,861 € dhe në anën tjetër me mbivlerësim të pasurisë për 3,654 €, si rezultat i regjistrimit të pjesshëm të pasurive dhe aplikimit të zhvlerësimit. Parregullsi në raportimin e detyrimeve kontingjente në Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF). Keqklasifikimi i shpenzimeve në kategoritë ekonomike adekuate në vlerë prej 80,899 €, si rezultat i ekzekutimit të pagesave bazuar në vendime gjyqësore/përmbarimore.	I kualifikuar	(9) të përsëritura	9
71	Komuna e Obiliqit	I kualifikuar	Komuna nuk kishte prezantuar saktë vlerën e pasurive në PFV. Pasuritë në vlerë prej 2,130,174€ nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurive, ndërsa vlera e pasurive ishte mbivlerësuar për gjithsej 109,475€, si rezultat i mosaplikimit të zhvlerësimit, aplikimit të gabuar të normës së zhvlerësimit dhe regjistrimit të dyfishtë të pasurive. Regjistri i pasurive nuk ishte harmonizuar me të dhënat e regjistrit kadastral. Në regjistrin e pasurive figurojnë 135 parcela në vlerë prej 7,129,043€ të cilat nuk rezultojnë në emër të Komunës, ndërsa në regjistrin kadastral figurojnë 114 parcela dhe një objekt në pronësi të Komunës që nuk janë përfshirë në regjistrin e pasurive.	I kualifikuar	(8) të reja (7) të përsëritura	15

			Për më tepër, disa objekte nuk janë evidentuar në kadastër, ndërsa 11 objekte/lokale vazhdojnë të figurojnë si pronë e Komunës, ndonëse nuk ekzistojnë më fizikisht. Komuna nuk kishte bartur në regjistrin e pasurive projekte të përfunduara dhe të pranura teknikisht, të cilat vazhdonin të figuronin si investime në vijim. Vlera e projekteve/situacioneve të mbetura si investime në vijim ishte 1,291,484€, ndërsa zhvlerësimi i paaplikuar për to ishte 54,583€, duke ndikuar në mbivlerësimin e pasurive. Komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë 1,911,816€ nga kategori ekonomike jo adekuate. Detyrimet kontingjente në PFV nuk ishin prezantuar saktë, pasi disa raste gjyqësore nuk ishin klasifikuar dhe vlerësuar drejt.			
72	Komuna e Parteshit	I kualifikuar	Dobësi në përgatitjen e raportit vjetor financiar. Komuna ka prezantuar mangësi në përgatitjen e Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV), duke përfshirë pasaktësi në raportimin e grantit qeveritar dhe të hyrave vetanake, mangësi të shpalosjes së llogarive të arkëtueshme dhe detyrimeve, si dhe mospërputhje të informacionit të prezantuar në shënimet shpjeguese të PFV-ve. Mangësi në evidencimin e pasurisë dhe mosaplikimi i zhvlerësimit. Pasuria e blerë në vlerë 9,137 € nuk ishte evidentuar në regjistrin e pasurisë.	I kualifikuar	(2) të reja (5) të përsëritura (1) pjesërisht i përsëritur	8
73	Komuna e Pejës	I kualifikuar	Komuna gjatë ekzekutimit të buxhetit kishte realizuar pagesa në vlerë 555,020€, nga kategoritë ekonomike jo adekuate. Pasuritë e komunës ishin të mbivlerësuar për 4,351,051€, si rezultat i regjistrimeve të gabuara dhe mos bartjes së pasurive.	I kualifikuar	(4) të reja (7) të përsëritura (1) pjesërisht i përsëritur	12

			Obligimet e papaguara janë mbivlerësuar për 30,610€, si rezultat i mosmbajtjes së evidencave të plota dhe të sakta.			
74	Komuna e Podujevës	I kualifikuar	Shpenzimet e prezantuara në PFV ishin keqklasifikuar në vlerën 3,653,581€, pasi që Thesari ka ekzekutuar pagesa bazuar në vendime gjyqësore nga buxheti i Komunës për paga jubilarë dhe shujta, të cilat janë regjistruar në kategori ekonomike jo adekuate.	I kualifikuar	(3) të reja (7) të përsëritura (1) pjesërisht i përsëritur	11
75	Komuna e Prishtinës	I kualifikuar	Në dy raste, obligimet e papaguara ishin paraqitur dy herë në PVF, duke rezultuar në mbivlerësim të detyrimeve për shumën prej 164,851€. Llogaritë e arkëtueshme në PVF ishin mbivlerësuar për 680,021€. Në 52 raste, në vlerë totale prej 7,766,370€, shpenzimet ishin klasifikuar në kategori ekonomike jo adekuate, përfshirë pagesa nga vendime gjyqësore/ përmbarimore dhe pagesa tjera të realizuara nga Komuna, duke ndikuar në paraqitjen e saktë të shpenzimeve në PVF. Detyrimet kontingjente në PVF ishin mbivlerësuar për 27,289,835€, si rezultat i prezantimit jo të saktë të lëndëve gjyqësore.	I kundërt	(8) të reja (14) të përsëritura (3) pjesërisht të përsëritura	25

76	Komuna e Prizrenit	I kualifikuar	Keqklasifikime në kategori të ndryshme ekonomike jo adekuate në vlerë prej 2,148,191€, pagesa të cilat janë realizuar përmes ekzekutimit të vendimeve gjyqësore/përmbarimore. Llogaritë e arkëtueshme të prezantuara në raportin vjetor financiar ishin nënvlerësuar për 355,098€. Mos raportimi i pasurive jo financiare në PFV si dhe mos mbyllja e investimeve në vijim.	I kualifikuar	(6) të reja (8) të përsëritura	14
77	Komuna e Rahovecit	I kualifikuar	Ishin bërë keqklasifikime të shpenzimeve në kategori të ndryshme ekonomike në vlerë prej 2,289,103 €.	I kualifikuar	(2) të reja (5) të përsëritura	7
78	Komuna e Ranillugut	I pamodifikuar		I kualifikuar	(1) i ri (5) të përsëritura	6
79	Komuna e Shtërpçës	I pamodifikuar		I kualifikuar	(7) të përsëritura	7
80	Komuna e Shtimes	I kualifikuar	Gjatë vitit 2025, bazuar në vendime gjyqësore Thesari ka ekzekutuar pagesa direkte në vlerë prej 582,606€ nga buxheti i Komunës për paga jubilarë dhe shtesa, të cilat janë regjistruar në kategori ekonomike joadekuate.	I kualifikuar	(3) të reja (6) të përsëritura (1) pjesërisht i përsëritur	10

81	Komuna e Skenderajt	I kualifikuar	Shpenzime në vlerë 493,807€ janë paguar dhe regjistruar në kategori ekonomike jo adekuate. Detyrimet kontingjente të prezantuara në pasqyrat vjetore financiare janë mbivlerësuar për 127,978€.	I kualifikuar	(2) të reja (8) të përsëritura (1) pjesërisht i përsëritur	11
82	Komuna e Suharekës	I kualifikuar	Gjatë vitit 2025, bazuar në vendime gjyqësore Thesari ka ekzekutuar pagesa në vlerë prej 3,082,897€ nga buxheti i Komunës për paga jubilarë dhe shujta, të cilat janë regjistruar në kategori ekonomike jo adekuate.	I kualifikuar	(5) të reja (7) të përsëritura (1) pjesërisht i përsëritur	13
83	Komuna e Vitisë	I kualifikuar	Pagesat në vlerë prej 2,817,932€ janë klasifikuar gabimisht në kategori të ndryshme ekonomike, si pasojë e ekzekutimit të vendimeve përmbartimore/gjyqësore. Këto keqklasifikime përfshijnë kategoritë e mallrave dhe shërbimeve, shpenzimeve komunale, subvencioneve dhe transfereve, si dhe investimeve kapitale. Po ashtu, në kuadër të kategorisë së mallrave dhe shërbimeve janë evidentuar 639,359€, të cilat janë klasifikuar gabimisht, pasi që sipas natyrës i takojnë kategorisë së pagave dhe mëditjeve. Në katër raste, pasuritë e pranuar përmes marrëveshjeve të mirëkuptimit, me vlerë totale prej 2,260,313€, nuk janë regjistruar në regjistrin e pasurive të Komunës. Janë evidentuar se 14 pasuri në vlerë 1,298,642€, të ndërtuara gjatë viteve 2013– 2020 dhe gjashtë pasuri të përfunduara gjatë viteve 2024–2025 në vlerë 2,112,674€ të cilat mbahen si investime në vijim, përderisa ato janë në shfrytëzim për tu klasifikuar si pasuri në përdorim.	I kualifikuar	(5) të reja (8) të përsëritura	13

84	Komuna e Vushtrrisë	I kualifikuar	Raportimi mbi detyrimet kontingjente, i shpalosur në PFV, ishte mbivlerësuar për 1,568,004€. Shpenzimet e prezantuara në PFV në vlerë totale 1,187,376€ nuk janë klasifikuar në kategoritë e duhura ekonomike, por janë raportuar në kategori të gabuara buxhetore, duke ndikuar në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive ekonomike adekuate. Pasuritë jofinanciare të shpalosura në pasqyrat vjetore financiare janë nënvlerësuar për 112,732€. Obligimet e papaguara të shpalosura në pasqyrat vjetore financiare janë mbivlerësuar për 74,427€. Llogaritë e arkëtueshme të shpalosura në pasqyrat vjetore financiare janë mbivlerësuar për 26,231€.	I kualifikuar	(4) të reja (12) të përsëritura	16
85	Komuna e Zubin Potokut	I kualifikuar	Pamundësia për të siguruar dëshmi të pagesave. Mosregjistrimi dhe mos shpalosja e pasurisë në PFV. Dobësitë në përgatitjen e PFV-ve.	I kualifikuar	(1) i ri (4) të përsëritura (2) pjesërisht të përsëritura	7
86	Komuna e Zveçanit	I kualifikuar	Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve. Mangësi në prezantimin e të dhënave në PFV.	I kualifikuar	(2) të reja (1) i përsëritur (1) pjesërisht i përsëritur	4

4. NDËRMARRJET PUBLIKE

87	Kompania Rajonale e Mbeturinave "Uniteti" Sh.A Mitrovicë	I kundërt	Kompania kishte të regjistruara në regjistrin e saj katër parcela me vlerë 1,378,000€, të cilat nuk janë as në pronësi dhe as në shfrytëzim të saj, dhe katër objekte me vlerë neto prej 97,500€, të cilat sipas dëshmive përkatëse, janë rrënuar në vitin 2021 dhe si të tilla nuk ekzistojnë më. Ndërsa, nuk e kishte regjistruar në regjistrin e pasurisë sipërfaqen ende në shfrytëzim nga Komuna e Mitrovicës vite më parë, të cilën kompania e shfrytëzon si deponi për menaxhimin e mbeturinave. Kompania në pasqyrat vjetore financiare kishte prezantuar llogaritë e arkëtueshme në vlerë neto prej 4,161,172€. Kompania nuk kishte kryer analiza gjithëpërfshirëse në lidhje me aftësinë e pagesës së borxheve nga konsumatorët dhe nuk kishte njohur fare provizione vjetore për llogaritë e arkëtueshme që nga viti 2018. Menaxhimi i llogarive të arkëtueshme nuk është efektiv, pasi kompania vazhdon të mbajë në regjistra 3,471,205€ borxhe të paarkëtueshme, prej të cilave 1,648,883€ borxhe të vjetra para vitit 2017 për klientët e Mitrovicës, 1,484,742€ për klientët e Vushtrrisë që nuk menaxhohen më nga kompania dhe 337,580€ për klientët pasivë në njësitë Mitrovicë dhe Skenderaj. Po ashtu, regjistri i llogarive të arkëtueshme nuk është i plotë, pasi borxhet e 10 klientëve në vlerë prej 118,622€ nuk janë të përfshira në regjistër dhe, rrjedhimisht, as në pasqyrat financiare. Të hyrat e shtyra nga grantet ishin prezantuar në vlerë 303,120€, ndërsa testimet tona tregojnë se vlera e prezantuar ishte nënvlerësuar për 324,810€. Si rrjedhojë, edhe të hyrat tjera të prezantuara në pasqyrën e të ardhurave ishin nënvlerësuar për 50,280€.	I kualifikuar	(3) të reja (17) të përsëritura (3) pjesërisht të përsëritura	23
----	--	-----------	--	---------------	---	----

			Korrigjimet e bëra në zërin "Rezervat Tjera" në shumën totale prej 1,531,455€ nuk janë dokumentuar dhe as nuk janë arsyetuar për llogaritjet që kanë çuar në realizimin e këtyre ndryshimeve. Keqprezantim i detyrimeve tatimore ndaj Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) në vlerë prej 469,887€, si rezultat i nënvlerësimit të tyre në regjistrat kontabël. Në pasqyrën e rrjedhës së parasë, ndërmarrja kishte përfshirë vlera që nuk përfaqësojnë rrjedha reale të parasë, konkretisht 40,630€ të evidentuara si rritje në detyrimet tjera, që paraqesin ndryshimin në fitimin e mbajtur, si dhe 205,999€ të evidentuara si ndryshime tjera në ekuitet, që paraqesin ndryshimin në zërin “rezervat tjera”. Këto ndryshime janë diferencë ndërmjet gjendjes së vitit 2025 dhe vitit 2024. Shpenzimet operative në pasqyrat financiare ishin nënvlerësuar për 16,336€ krahasuar me shënimet kontabël. Ndërsa, shpenzimet për polisa sigurimi në vlerë prej 5,280€ dhe pagesa prej 1,468€ për depozitë sigurie janë trajtuar gabimisht si shpenzim, duke ndikuar në mbivlerësim të shpenzimeve. Prezantimi i llogarive të pagueshme tregtare në pasqyrat financiare nuk ishte i saktë, pasi nuk ishin përfshirë dy fatura në vlerë 12,879€. Shpenzimet e pagave të raportuara në pasqyrat financiare (1,387,989€) nuk përputhen me ato të deklaruara në ATK (1,394,256€), me një diferencë prej 6,267€. Janë identifikuar pasaktësi në trajtimin e të hyrave, përfshirë korrigjimet e viteve të kaluara në vlerë prej 25,985€ të reflektuara në vitin aktual, trajtimin e kthimit të akontacioneve në vlerë prej			
--	--	--	--	--	--	--

			3,550€ si zvogëlim i të hyrave, si dhe njohjen e të hyrave në vlerë prej 3,497€ në periudha jo përkatëse.			
88	Korporata Energjetike e Kosovës	I kualifikuar	Ndërmarrja nuk ka arritur të finalizojë përditësimin e regjistrit të pasurive të paluajtshme, pavarësisht veprimeve të ndërmarra gjatë vitit 2025. Në regjistër vazhdojnë të figurojnë prona që nuk janë në pronësi të ndërmarrjes, përfshirë pesë prona të transferuara te Infrakos në vlerë 7,867,541€, 11 parcela të identifikuar për fshirje në vlerë 866,223€, si dhe prona “Mali i pyllëzuar” në Podujevë në vlerë 5,000,000€. Po ashtu, prona në Prishtinë nuk është përditësuar sipas certifikatës së pronësisë, ndërsa ajo në Vasilevë është vetëm pjesërisht e regjistruar. Gjithashtu, janë evidentuar mangësi në regjistrin e pasurive, përfshirë përshkrimet e paplota dhe parcelat e pabartuara nga proceset e shpronësimit. Menaxhmenti gjatë vitit 2023 ka kryer rivlerësim vetëm për kategorinë e tokave, ndërsa kategoritë tjera të pasurive janë mbajtur sipas modelit të kostos fillestare. Megjithatë, regjistri i pasurive përmban 472 pasuri me vlerë neto 7,744,723€ që nuk janë në përputhje me këtë model. Në regjistër janë 5,376 pasuri me vlerë fillestare, të rivlerësuar dhe vlerë neto zero, duke përfshirë objekte, rrugë, hekurudha, rrjete, largpërçues, pajisje dhe makineri. Ndërmarrja nuk kishte bërë trajtimin e plotë të rezultateve të komisionit të inventarizimit dhe nuk kishte bërë harmonizimin e plotë të rezultateve me shënimet kontabël, të cilat përfshijnë mos harmonizim të pasurive në vlerë 135,501€.	I kualifikuar	(6) të reja (6) të përsëritura	12

89	KRM “Pastërtia” Sh.A.	I kundërt	Ndërmarrja në pasqyrat financiare të vitit 2025 kishte prezantuar llogaritë e arkëtueshme në vlerë neto prej 4,375,357€. Ndërmarrja nuk kishte kryer analiza gjithëpërfshirëse në lidhje me aftësinë e pagesës së borxheve nga konsumatorët dhe nuk kishte njohur fare provizione vjetore për llogaritë e arkëtueshme që nga viti 2018. Ndërmarrja ka paraqitur 3,207,724€ si rezerva të tjera në pasqyrat financiare pa evidencë të mjaftueshme. Kjo zë përfshin transaksione që nuk janë të natyrës së rezervave të tjera (si tatime, provizione, falje borxhesh). Ndërmarrja që nga viti 2018 e këndej nuk kishte bërë vlerësimin e pasurive të ndërmarrjes. Ne kemi identifikuar se në regjistrin kontabël të pasurive janë të përfshira një numër i konsiderueshëm prej 99 pasurive me kosto historike në shumën prej 1,094,384€ dhe që janë të zhvlerësuara në tërësi, pra vlera neto e tyre në librat kontabël është zero (0). Edhe pse këto pasuri janë ende aktive, nuk ishte bërë rivlerësimi dhe rishikimi i jetëgjatësisë së tyre prej 7 vitesh. Ndërmarrja ka paraqitur në pasqyrat financiare për vitin 2025 detyrime afatshkurtra në vlerë prej 121,006€. Megjithatë, këto shuma lidhen me konteste gjyqësore ende të pazgjdhura dhe nuk përfaqësojnë detyrime të konfirmuara në bazë të një vendimi përfundimtar të gjykatës. Ndërmarrja obligimet tatimore i kishte nënvlerësuar në pasqyrat financiare për vitin 2025 në shumën prej 108,465€, duke mos reflektuar gjendjen e saktë të borxhit tatimor ndaj ATK-së. Pasuritë e prekshme dhe të paprekshme, për 6 mostrat e testuara në vlerë totale prej 89,169€, nuk janë mbështetur me dëshmi të mjaftueshme, pasi këto dëshmi nuk janë siguruar, dhe për rrjedhojë	I kundërt	(16) të reja (2) të përsëritura (1) pjesërisht i përsëritur	19
----	--------------------------	-----------	---	-----------	---	----

			nuk kemi qenë në gjendje t'i verifikojmë dhe t'i paraqesim nëse gjendja e tyre është e saktë në pasqyrat financiare. Fitimet e mbajtura në vitin 2025 janë të pasakta për shkak se në vitin 2024 është paraqitur shpërndarja e dividendës prej 86,011€ pa vendim dhe dokumentacion mbështetës, e përdorur si shifër balancuese, duke ndikuar në pasqyrimin jo të saktë të pasqyrave financiare dhe shënimeve shpjeguese.			
90	KRU "Hidrodrini" Sh.A.	I kundërt	Mangësi në prezantim të pasurive afatgjata në pasqyrën e pozicionit financiar. Ndërmarrja nuk kishte bërë rivlerësimin e pasurive fikse që nga viti 2005. Pjesa e investimeve për projektin "Ujësjiellësi dhe kanalizimi në zonat rurale, faza VI" në vlerë 345,508€, nuk ishin regjistruar në regjistrin e aseteve të ndërmarrjes. Llogaritë e arkëtueshme të prezantuara në pasqyrat financiare, krahasuar me shënimet analitike, kishin rezultuar me një diferencë prej 1,026,714€. Arkëtimet në shumën prej 199,928€, nuk janë zbritur konsumatorëve përkatës për obligimet e paguara ndaj ndërmarrjes, por këto mjete ishin regjistruar me përshkrimin "Konsumator i paidentifikuar". Ndërmarrja nuk i kishte provizionuar llogaritë e arkëtueshme siç kërkohet me standard. Nga analiza e bilancit vërtetues, është konstatuar se të pagueshmet tregtare janë paraqitur me gjendje debitore prej 346,944€, çka nuk është në përputhje me natyrën e kësaj llogarie.	I kualifikuar	(2) të reja (8) të përsëritura (4) pjesërisht të përsëritura	14

			Të hyrat e shtyra nga grantet ishin të mbivlerësuara për 950,494€, ndërsa të hyrat nga grantet në pasqyrën e të ardhurave ishin të nënvlerësuara për 430,490€. Mungesa e evidencës për rezervën e rivlerësimit në vlerë prej 21,744,554€ dhe mos amortizimi i saj ndër vite krijon pasiguri për saktësinë e regjistrimeve të duhura kontabël. Ndërmarrja nuk posedon dëshmi përkatëse për pranimin e 3,066 artikujve në vlerë 121,567€, të cilat ishin pranuar si donacion dhe të njëjtat figurojnë ende në stok. Në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare mungonin informacione të rëndësishme. Ndërmarrja nuk ka shpalosur informacione për përbërjen e investimeve në vijim, të hyrat nga grantet dhe detyrimet kontingjente.			
91	Ndërmarrja Publike “KOSTT”	I kualifikuar	Në regjistrin e pasurive të ndërmarrjes, figurojnë 401 pasuri të trashëguara nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), të cilat janë regjistruar me kosto historike zero. Prej tyre 39 parcela toke, 10 ndërtesa, 26 rrugë, 134 pajisje të rrjetit dhe 192 pajisje tjera. Që nga themelimi i saj, ndërmarrja nuk ka ndërmarrë ndonjë process rivlerësimi për këto pasuri dhe nuk ka përcaktuar vlerën e tyre kontabël në Pasqyrat financiare. Ndërmarrja nuk kishte dëshmi të pronësisë për sipërfaqen e tokave prej 5.86 hektar që është e regjistruar në regjistër të pasurive dhe për të gjitha ndërtesat e trashëguara nga KEK. Po ashtu, ndërmarrja ka në regjistrat të saj të regjistruar 11 apartamente të trashëguara me vlerë neto në libra 149,355€ për të cilat nuk ka informata të statusit të tyre pronësor dhe të njëjtat nuk janë në shfrytëzim të ndërmarrjes.	I kualifikuar	(5) të reja (6) të përsëritura	11

			Për shkak të natyrës së çështjes auditori nuk ka arritur të identifikoj vlerën financiare të mos-regjistrimit por gabime konsiderohet material në aspektin e keq-deklarimit. Ndërmarrja nuk kishte trajtuar shpenzimet për tarifat e menaxhimit dhe zotimit të kredisë për projektin ‘Përmirësimi i rrjetit të transmetimit – Faza VII’, si dhe asetet, në përputhje me kërkesat e standardeve. Ndërmarrja nuk posedon evidencë të detajuar për provizionet gjyqësore, duke rezultuar në njohje të gabuar të shpenzimeve dhe nevojën për korrigjimin e gabimeve të periudhave të mëparshme.			
92	Ndërmarrja Publike “Termokos“	I kualifikuar	Për shkak të përfshirjes së rivlerësimit të regjistri i granteve, të hyrat e shtyra janë mbivlerësuar për 1,741,280€. Në 13 raste pasuritë e financuara nga grantet me kosto fillestare prej 4,056,598€ (vlerë neto 3,255,425€), janë regjistruar gabimisht si pasuri të zhvlerësueshme. Po ashtu, në 10 raste, kostoja e aseteve është nënvlerësuar për 1,465,128€. Si rezultat i trajtimit jo të duhur kontabël, pasuritë afatgjata janë nënvlerësuar për 3,980,792€, dhe njëkohësisht janë mbivlerësuar për 3,375,447€, për shkak të klasifikimit të gabuar të parapagimeve si pasuri dhe aplikimit të zhvlerësimit mbi to. Në 47 raste, shpenzimet e interesit, pagave dhe konsulencës, në vlerë totale prej 4,469,410€, janë regjistruar si pasuri të zhvlerësueshme, pa iu atribuar pasurisë përkatëse. Njohje e gabuar e të hyrave nga amortizimi i granteve ka rezultuar në pasqyrim jo të drejtë në pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së parasë dhe pasqyrën e ekuitetit, për shumën 133,681€.	I kualifikuar	(9) të reja (9) të përsëritura (2) pjesërisht të përsëritura	20

		Në dy raste, pasuritë e klasifikuara si investime në vijim, në vlerë prej 457,508€, janë përfshirë njëkohësisht edhe në regjistrin e pasurive në përdorim, duke rezultuar në mbivlerësim të pasurive për këtë shumë. Pasuritë në vlerë neto prej 8,166,058€, të cilat i përkasin të njëjtës klasë, nuk janë përfshirë në procesin e rivlerësimit. Në katër (4) raste, llogaritë e pagueshme janë mbivlerësuar në pasqyrat financiare për 401,713€, ndërsa në një (1) rast janë nënvlerësuar për 40,000€. Llogaritë e arkëtueshme të prezantuara në pasqyrat financiare, krahasuar me shënimet analitike, kanë rezultuar me një diferencë për 316,108€. Po ashtu, pesë (5) raste, llogarive të arkëtueshme në vlerë 128,777€, nuk janë të mbështetura me dëshmi përkatëse. Në kuadër të zërit “Konsumatorët tjerë”, ndërmarrja ka prezantuar një llogari të arkëtueshme me emërtimin “Borxhi i ngrirë” në vlerë prej 371,802€, e cila rrjedh nga një vendim i Bordit dhe aksionarëve i vitit 2010. Mospërputhje në politikat kontabël dhe shpalosje jo e plotë e informacionit në pasqyrat financiare sa i përket matjes së aseteve dhe metodologjisë së llogaritjes së lejimeve. Ndërmarrja nuk ka njohur provizione për 26 konteste gjyqësore me humbje të mundshme prej 600,936€ dhe fitime të mundshme prej 16,297€ në përputhje me kërkesat përkatëse. Po ashtu, prona e ndërmarrjes me sipërfaqe 24,309m² e cila nuk është në shfrytëzim të ndërmarrjes, nuk është shpalosur në pasqyrat financiare.			
--	--	---	--	--	--

93	Ndërmarrja Publike Kompania Rajonale e Ujësjesit "Prishtina" Sh.A.	I kualifikuar	Ndërmarrja ka mbivlerësuar të hyrat për 27,490€, rrjedhimisht edhe fitimin neto e kishte mbivlerësuar për këtë vlerë. Po ashtu, janë mbivlerësuar shpenzimet e TVSH-së për 2,390€ dhe llogaritë e arkëtueshme për 29,880€, nga faturimi financiar të një ujëmatësi i cili shërbente vetëm për matjen e sasisë së ujit. Ndërmarrja nuk ka kryer rishikimin e vlerës së mbetur të pasurisë në fund të vitit raportues. Si rezultat, në regjistrin e pasurive u identifikuan mangësi, përfshirë 3,240 pasuri në përdorim, të cilat janë zhvlerësuar plotësisht pa jetë të dobishme, me vlerë fillestare 13,254,718€. Në mungesë të informacioneve të sakta mbi vlerën e këtyre pasurive, ishte e pamundur të vlerësojmë saktësisht vlerën financiare të pasurive në përdorim. Ndërmarrja ka mbivlerësuar vlerën neto të pasurisë për 54,746€, nga aplikimi i gabuar i zhvlerësimit. Ndërmarrja ka mbivlerësuar llogarinë e arkëtueshme në vlerë prej 46,743.23€. Në dy raste ndërmarrja kishte prezantuar si LLA shumën 47,147.55€, ndërsa sipas letrës së konfirmimit të pranuar nga klientët vlere e tyre ishte vetëm 403.32€. Ndërmarrja nuk kishte raportuar saktë zërin "Parapagimet dhe të arkëtueshmet tjera", pasi nuk kishte bërë zbritjen e shpenzimeve të qirasë në vlerë prej 23,540€.	I kualifikuar	(6) të reja (3) pjesërisht të përsëritura (10) të përsëritura	19
94	Ndërmarrja Publike Trepça Sh.A.	I kundërt	Ndërmarrja nuk ka zbatuar në mënyrë të plotë kërkesat e SNK 2 "Inventarët" lidhur me matjen dhe prezantimin e stoqeve në pasqyrat financiare. Për një pjesë të konsiderueshme të stoqeve, në veçanti për mbetjet teknologjike/sterilin dhe mbeturinat e procesit të përfitimit të piritit (FeS₂) dhe pirotinës (FeS) në vlerë prej 23,187,129€, nuk janë ofruar dëshmi të mjaftueshme dhe të	I kundërt	(10) të reja (26) të përsëritura	36

			besueshme për metodologjinë e përdorur në përcaktimin e vlerës, duke krijuar pasiguri mbi saktësinë e tyre. Ndërmarrja ka prezantuar në Pasqyrën e të Ardhurave dhe në Pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet vlera që nuk përputhen me shënimet kontabël dhe evidencën mbështetëse, duke rezultuar në mospërputhje materiale ndërmjet pasqyrave financiare dhe regjistrave kontabël. Këto pasaktësi ndikojnë në paraqitjen e drejtë dhe të besueshme të performancës financiare dhe pozicionit financiar të ndërmarrjes për periudhën raportuese. Ndërmarrja nuk ka paraqitur saktë obligimin e klientit si llogari të arkëtueshme, si rezultat, pasqyrat financiare paraqesin mbivlerësim të llogarive të arkëtueshme për 376,245€. Ndërmarrja nuk ka siguruar regjistrim të plotë dhe të saktë të pasurive afatgjata dhe nuk ka siguruar dokumentacion për pasurinë në vlerë prej 42,755,994€. Si rezultat, pasuritë e paluajtshme dhe të dhënat përkatëse nuk janë të pasqyruara në mënyrë të plotë dhe të saktë në pasqyrat financiare, duke ndikuar në besueshmërinë e raportimit financiar dhe duke rritur rrezikun e keqmenaxhimit dhe humbjes së pasurive. Ndërmarrja nuk kishte aplikuar fare zhvlerësimin për ndërtesat dhe strukturat ndërtimore, vlera e të cilave ishte prezantuar në pasqyrat financiare 45,984,576€, dhe automjete transporti dhe pajisjet në vlerë 112,538,322€, për shkak të mungesës së një politike të qartë dhe të unifikuar për zhvlerësimin e pasurive në njësitë e saj. Për pasojë, ekziston rreziku që pasuritë dhe rezultatet financiare të jenë materialisht të shtrembëruara, duke ndikuar në paraqitjen e drejtë të pozitës financiare të ndërmarrjes.			
--	--	--	---	--	--	--

			Shënimet kontabël nga të cilat rrjedhin pasqyrat financiare nuk respektojnë parimin e kontabilitetit të dyfishtë, pasi ana kreditore tejkalon anën debitore për 10,252,608€, duke reflektuar mungesë të kontrolleve dhe duke cenuar besueshmërinë e të dhënave kontabël dhe pasqyrave financiare të ndërmarrjes. Ndërmarrja nuk ka shpalosur në pasqyrat financiare detyrimet kontingjente në vlerë prej 5,911,008€ nga kontestet gjyqësore, për shkak të mungesës së bashkëpunimit mes zyrës ligjore dhe financave si dhe mungesës së procedurave të brendshme. Ndërmarrja nuk ka ofruar dëshmi mbështetëse për vlerën e kapitalit aksionar prej 596,084,306€, duke pasur mospërputhje me statutin që e përcakton kapitalin themeltar në 10,000€. Mungesa e dokumentacionit mbështetës të mjaftueshëm për të dëshmuar origjinën, përbërjen dhe ndryshimet e këtyre zërave, e bën të pamundur të marrim siguri për këtë llogari. Ndërmarrja nuk ka siguruar harmonizim të plotë ndërmjet regjistrit analitik të pasurive dhe pasqyrave financiare, duke rezultuar në mospërputhje materiale në vlerat e pasurive afatgjata, në shumë prej 2,846,203€. Si rezultat, pasqyrat financiare nuk paraqesin në mënyrë të drejtë dhe të besueshme pozitën financiare të ndërmarrjes. Ndërmarrja kishte mbivlerësuar llogaritë e arkëtueshme në vlerë prej 1,202,606€, për shkak të mungesës së dokumentacionit mbështetës dhe moszbritjes së pagesave për shpronësimin. Gjatë auditimit konstatuam se ndërmarrja nuk kishte siguruar dokumentacion të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm mbështetës për verifikimin e një pjese të të hyrave të regjistruara në Librin Kryesor në vlerë prej 243,572€. Po ashtu, u identifikuan mospërputhje			
--	--	--	---	--	--	--

			ndërmjet Librit Kryesor dhe Pasqyrave Financiare Vjetore, si dhe llogaritje jo të sakta të disa të hyrave nga shërbimet. Ndërmarrja nuk ka përjashtuar transaksionin ndërmjet njësive të saj gjatë konsolidimit financiar, duke përfshirë gabimisht shumën prej 780,472€ në llogaritë e arkëtueshme tjera. Kemi identifikuar raste të klasifikimit jo të duhur të investimeve kapitale dhe pasurive jo-materiale, të cilat janë regjistruar si shpenzime operative në kundërshtim me kërkesat e SNK/IAS 16 dhe SNK/IAS 38. Si rezultat, shpenzimet operative janë mbivlerësuar për shumën prej 140,416€, duke ndikuar në paraqitjen e drejtë dhe të saktë të pasqyrave financiare. Ndërmarrja nuk ka reflektuar në mënyrë të plotë dhe të saktë efektet e faturave finale dhe notave kreditore që rrjedhin nga kontratat e shitjes, duke ndikuar në paraqitjen jo të drejtë të të hyrave në pasqyrat financiare. Si rezultat, të hyrat nga shitjet janë mbivlerësuar për 59,049€, duke bërë që pasqyrat financiare të mos paraqesin në mënyrë të saktë gjendjen financiare dhe rezultatin nga të hyrat në kundërshtim me kërkesat e SNFR 15. Ndërmarrja nuk ka trajtuar në mënyrë të drejtë obligimet e bartura nga vitet paraprake në kartelat e klientëve dhe në regjistrat kontabël. Si rezultat, një pjesë e këtyre obligimeve është regjistruar gabimisht si të hyra të vitit 2025, duke çuar në mbivlerësim të shitjeve/të hyrave në vlerë prej 75,781€ dhe njëkohësisht në nënvlerësim të llogarive të arkëtueshme. Për më tepër, edhe mosverifikimi i obligimeve për klientët para përgatitjes së PFV ka ndikuar në nënvlerësim të llogarive të arkëtueshme. Mosregjistrimi i saktë i obligimeve të bartura nga periodat e kaluara dhe mosverifikimi i obligimit për klientët ka			
--	--	--	--	--	--	--

			rezultuar në nënvlerësim të llogarive të arkëtueshme në vlerë prej 152,174€. Gjatë auditimit konstatuam se ndërmarrja nuk ka zbatuar në mënyrë të qëndrueshme parimin akrual gjatë njohjes së shpenzimeve, duke rezultuar në regjistrim të transaksioneve në periudha të gabuara. Janë identifikuar raste ku shpenzimet janë njohur në momentin e pagesës në regjistrat kontabël dhe jo kur ka lindur detyrimi në vlerë 259,892€, ndërsa për vlerën 380,516€ shpenzimet janë nënvlerësuar, dhe raste të mospërputhjes së shpenzimeve me regjistrimet kontabël dhe pasqyrat financiare në vlerë 370,048€. Ndërmarrja ka prezantuar detyrime ndaj granteve në pasqyrat financiare pa ofruar dëshmi mbështetëse për to në vlerë 3,071,409€, për shkak të mungesës së databazës së pasurive të financuara nga grantet, duke rritur rrezikun për pasqyrim jo të saktë të tyre në pasqyrat financiare. Ndërmarrja kishte përfshirë gabimisht parapagimet e klientëve, në shumë prej 456,745€, në analitikën e llogarive të arkëtueshme si vlera negative, duke rezultuar në nënvlerësim të llogarive të arkëtueshme në pasqyrat financiare. Po ashtu, vlera e parapagimeve të prezantuara në pasqyrat financiare ishte nënvlerësuar për 82,639€. Ndërmarrja obligimet ndaj tatimit në burim i kishte prezantuar të nënvlerësuar në pasqyrat financiare për vitin 2025 në shumën prej 37,225€, përderisa obligimet ndaj kontributeve pensionale i kishte prezantuar të mbivlerësuar për vlerë 51,615€, duke mos reflektuar gjendjen e saktë të borxhit tatimor ndaj ATK-së. Kemi identifikuar mospërputhje materiale ndërmjet pasqyrave financiare dhe evidencave kontabël lidhur me detyrimet			
--	--	--	---	--	--	--

			afatshkurtra, përfshirë interesin e pagueshëm për rentën minerare dhe llogaritë e pagueshme. Gjithashtu, për detyrimet në vlerë prej 4,803,981€ nuk kemi mundur të sigurojmë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme auditimi për të verifikuar ekzistencën, saktësinë dhe plotësinë e tyre.			
95	NPH “Ibër - Lepenc” Sh.A.	I kualifikuar	Ndërmarrja në pasqyrat financiare më 31.12.2025 tek zëri i parapagimeve ka paraqitur shumë prej 2,820,901€, nga kjo shumë 934,216€ nuk i përkasin parapagimeve por pasurive të kushtëzuara. Rrjedhimisht, për këtë shumë kemi mbivlerësim të pasurive afatshkurtra. Mbivlerësimi i pasurisë si pasojë e moszbatimit të amortizimit për dy muajt e vitit 2025, pas rivlerësimit në vlerë prej 300,189€. Në vitin 2025 ndërmarrja ka kryer vlerësimin për herë të parë të pasurisë tokës dhe e ka njohur si pasuri në pasqyrat financiare me vlerë prej 25,438,800€. Si rezultat i këtij vlerësimi, ndërmarrja ka rritur fitimet e mbajtura për të njëjtën shumë (25,438,800€). Megjithatë, ndërmarrja nuk ka njohur detyrimin për tatimin e shtyrë në vlerë prej 2,543,800€. Në vitin 2025 ndërmarrja ka kryer vlerësimin për herë të parë të një pasurie afatgjatë në vlerë prej 1,547,952€, e cila në periudhat e mëparshme nuk ka qenë e regjistruar dhe as e paraqitur në pasqyrat financiare. Si rezultat i këtij veprimi, ndërmarrja ka rritur rezervën e rivlerësimit në kapital për 1,547,952€, nuk i ka rritur fitimet e mbajtura dhe nuk ka njohur detyrime për tatimin e shtyrë ashtu siç kërkohet me standardin SNK 12 “Tatimi mbi të ardhurat”. Shuma e rezervës së rivlerësimit e prezantuar në pasqyrat financiare ishte 202,404,505€, si rezultat i rritjes së vlerës së pasurive nga rivlerësimi i kryer në vitin 2007 në vlerë 162,424,909€, si dhe	I kualifikuar	(7) të reja (4) të përsëritura	11

			rivlerësimit të pasurisë në vlerë 39,979,596€ që ka ndodhur në vitin 2025. Ndërmarrja nuk kishte përlllogaritur zhvlerësimin e rezervës rivlerësuese nga viti 2008 e këndeje. Ndërmarrja kishte prezantuar pronat e kategorisë tokë në PFV për vitin 2025. Gjashtë prona me sipërfaqe prej 21.1 hektarësh janë në shfrytëzim nga ndërmarrja, por pa dëshmi të pronësisë; dy parcela me sipërfaqe prej 85,901m², ku ndërmarrja nuk ka informacione se ku gjinden si lokacione dhe për çka shfrytëzohen; tre parcela me sipërfaqe 176,542m² të cilat nuk shfrytëzohen nga NPH “Ibër Lepenc”, në total pesë parcela me sipërfaqe prej 328,097m² figurojnë në regjistrin e rivlerësimit të aseteve dhe në regjistrin e aseteve të ndërmarrjes, por nuk gjinden në regjistrin total të pronave nga kadastra dhe nuk kanë certifikata të pronësisë. Gjithashtu, 58 parcela në Ribariq, Tutin–Novi Pazar, me sipërfaqe totale prej 167,531m², të cilat janë në pronësi të ndërmarrjes, por ndodhen në territorin e Republikës së Serbisë, nuk ishin përfshirë në regjistrin e pasurive. Të hyrat e shtyra nga grantet të prezantuara në pasqyrën e pozicionit financiar reflektojnë një diferencë në vlerë prej 159,784 € krahasuar me shënimet analitike, që kanë derivuar nga mospërputhja në shënimet nga PFV-të e vitit 2024 e që kanë ndikim edhe në PFV 2025.			
96	Radio Televizioni i Kosovës	I pamodifikuar		I kualifikuar	(6) të reja (2) të përsëritura	8

97	Stacioni i Autobusëve Sh.A. Prishtinë	I kundërt	Ndërmarrja kishte prezantuar pasuri afatgjata në pasqyrat financiare vjetore me vlerë prej 20,514,007€. Megjithatë, janë identifikuar dobësi të rëndësishme në menaxhimin dhe regjistrimin e pasurive, të cilat ndikojnë në besueshmërinë dhe plotësinë e informacionit financiar. Ndërmarrja gjatë vitit 2025 kishte pranuar dy raporte të rivlerësimit për pasuritë e paluajtshme dhe për pasuritë e luajtshme. Megjithatë, për pasuritë e paluajtshme nuk kishte trajtuar eliminimin e zhvlerësimit të akumuluar në vlerë prej 390,620€, ndërsa për pasuritë e luajtshme rivlerësimi nuk është reflektuar në regjistrat kontabël dhe pasqyrat financiare vjetore. Ndërmarrja kishte prezantuar në pasqyrën e pozicionit financiar tek gjithsej ekuiteti vlerën 21,665,491€, mirëpo për vlerën e fitimeve të mbajtura (2,172,383€) dhe saldon fillestare të rezervave tjera në vlerë 14,196,665€, ndërmarrja nuk posedon evidenca analitike mbështetëse për këto saldo të cilat do të mundësonin verifikimin e lëvizjeve të tyre ndër vite. Ndërmarrja tek pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse kishte prezantuar të hyrat në vlerë 1,745,583€, duke i mbivlerësuar ato për 289,559€. Ndërmarrja në pasqyrën e pozitës financiare pasuritë dhe detyrimet tjera afatshkurtra nuk i kishte prezantuar sipas dokumenteve burimore apo shënimeve kontabël. Ndërmarrja kishte prezantuar në pasqyrën e pozitës financiare llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera në vlerë neto prej 119,451€. Ndërmarrja nuk kishte kryer analiza gjithëpërfshirëse në lidhje me aftësinë e pagesës së borxheve nga klientët dhe nuk kishte	I kundërt	(14) të reja (2) të përsëritura (1) pjesërisht të përsëritura	17
----	---------------------------------------	-----------	---	-----------	---	----

			njohur fare provizionime vjetore për llogaritë e arkëtueshme ndër vite. Ndërmarrja nuk kishte bërë harmonizimin e llogarive të arkëtueshme me klientët e saj dhe si rrjedhojë me (2) dy klientë nuk kishte bërë harmonizimin periodik, duke rezultuar me diferencë prej 10,033€ me shënimet kontabël, në (2) dy raste, ndërmarrja kishte faturuar pa kontratë dhe klientët refuzojnë obligimet e tyre në vlerë prej 42,873€. Shënimet kontabël nga të cilat rrjedhin pasqyrat financiare nuk respektojnë parimin e kontabilitetit të dyfishtë, pasi ana kreditore tejkalon anën debitore për 14,530€, duke reflektuar mungesë të kontrolleve dhe duke cenuar besueshmërinë e të dhënave kontabël dhe pasqyrave financiare të ndërmarrjes. Ndërmarrja nuk kishte përpiluar PFV-të në bazë të modelit ilustrues të prezantimit të PFV-ve dhe nuk kishte prezantuar saktë informacionet krahasuese për periudhën paraprake në pasqyrat financiare. Ndërmarrja nuk kishte bërë shpalosjen e të dhënave të prezantuara në PFV sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit.			
--	--	--	--	--	--	--

5. AUDITIME TË VEÇANTA

98	Projekti ‘Raporti i auditimit për raportin financiar vjetor të Korporatës Energjetike të Kosovës për qëllime të veçanta mbi rentën minerare të paguar për licencat për vitin 2025’	I pamodifikuar				
99	Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetor për Qëllime të Veçanta të Divizioneve të Ndara të Korporatës Energjetike të Kosovës për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë – Viti 2025.	I pamodifikuar				

Numri total i opinioneve, konkluzioneve dhe rekomandimeve nga raportet e auditimit për vitin 2025.

Raportet e rregullsisë të publikuara për periudhën 01.01.2026-30.06.2026	99		
OPINIONI	I kualifikuar (57)	I pamodifikuar (37)	I kundërt (5)
KONKLUZIONI	I kualifikuar (62)	I pamodifikuar (31)	I kundërt (4)
REKOMANDIME	823		

Shtojca 1 - Përkufizimi i opinionëve dhe konkluzioneve të auditimit

I pamodifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi (et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpijë në shmangie të keq-deklarimit (eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë (ve).

I kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetme apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpijë në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

I kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetme apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.